VENDIM
Nr. 808, datë 26.11.2014

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2014, MIRATUAR PËR PRESIDENCËN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", dhe të neneve 10 e 13, të ligjit nr.185/2013, "Për buxhetin e vitit 2014", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Presidencës, në buxhetin e miratuar për vitin 2014, t'i shtohet fondi prej 3 000 000 (tre milionë) lekësh, për shpenzime korrente.
2. Ky fond të përballohet nga fondi i kontingjencës, miratuar për vitin 2014.
3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Presidenca për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama